

Shoqëria "ALDENT" është person juridik i njohur me vendimin Nr.29008 dt.06/02/2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Me Urdhër Nr.76, dt.03/04/2003, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, shoqëria "ALDENT" hap shkollën 2-vjeçare për Laborant Dentar.

Pas tre vitesh eksperience me këtë shkollë, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 673, Dt 22.09 2006 jepet leja për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare jobublike "ALDENT", e cila formon specialistë të lartë në drejtimin "Laborant Dentar, program i ciklit të parë të studimit, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me sistemin e studimeve me kohë të plotë.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 27.02.2008 është licensuar programi i integruar i studimit të ciklit të dytë në "Stomatologji"(5 vite akademike). Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.794, date 22.07.2009 është licensuar programi i studimit të ciklit

të parë në "Infermieri e përgjithshme"(Bachelor-3 vite akademike) dhe me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr.527 Dt 1/11/2012 është licensuar programi i i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në Infermieri Klinike.

Me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr 519, dt 19.11.2010 është licensuar programi i integruar i studimit të ciklit të dytë në "Farmaci"(5 vite akademike). Me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr.370, Dt.27.7.2011 është licensuar programi i studimit të ciklit të parë në Fizioterapi. (Bachelor-3vite akademike) dhe me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr.195, Dt28.05.2013 është licensuar programi i i studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në Fizioterapi. Me Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës Nr.299 Dt 22/7/2013 janë licensuar programet e studimit të ciklit të tretë Specializim afatgjatë në Ortodonti dhe Kirurgji Orale.

## 1.2 Licensimi dhe Akreditimi

### Cfarë është licensimi?

Ligji për arsimin e Lartë cakton një sërë kushtesh dhe kriteresh që duhet të plotësojë një institucion i caktuar që të fillojë veprimtarinë e tij në fushën e arsimit të lartë dhe të hap programe të ndryshme studimi. Plotësimi i dokumentacionit, sigurimi i infrastrukturës dhe bazës materiale, plotësimi me staf akademik monitorohen sipas rregullave rigorozisht të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe Agjencia Publike E Akreditimit Të Arsimit Të Lartë. Pasi plotësohen këto kushte jepet leja për hapjen e institucionit dhe programeve të studimit me vendim të Këshillit Të Ministrave ose me Urdhër Të Ministrisë përgjegjës për arsimin.

### Cfarë është akreditimi?

Akreditimi është një procedurë transparente e kontrollit të cilësisë, gjatë së cilës një organ i pavarur vërteton në bazë të standardeve të përcaktuara, të krahasueshme ndërkombëtarisht nëse institucionet universitare përkatësisht drejtimet e studimeve i përmbushin kërkesat minimale të cilësisë. Procedurat e akreditimit vendosin për statusin dhe njohjen e lidhur me të si dhe statusin juridik të institucioneve dhe drejtimeve të studimit për një kohë të caktuar. Akreditimi në fushën e arsimit të lartë i ofron shoqërisë dhe grupeve të interesit siguri që cilësia e mësimdhënies dhe

studimit i përgjigjet kërkesave ndërkombëtare, njëkohësisht rrit nivelin e transparencës në tregun gjithnjë e më të paqartë të ofertave kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit. Funkcionet qenësore të akreditimit janë:

- **Mbrojtja e studentëve nga ofertat, të cilat nuk dëshmojnë që dërgojnë deri tek arritja e rezultateve të parapara (shanset për punësim, njohjen ndërkombëtare të gradës së fituar etj.);**
- **Transparencë, krahasueshmëri dhe përmes kësaj më shumë mundësi zgjedhjeje në tregun e arsimit dhe të punës si në vend ashtu edhe në tërë hapësirën evropiane të arsimit të lartë;**
- **Lehtësimi i mobilitetit ndërkombëtar përmes njohjes së anasjelltë të studimeve dhe përmirësimi i mundësive të diplomuarve në tregun evropian të punës;**
- **Krijimi i një baze për konkurrencën midis institucioneve të arsimit për studentë përkatësisht për mjete publike ose private.**

Më poshtë jepet tabela përmbledhëse e programeve të studimit të Universitetit ALDENT si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës që vërtetojnë licensimin dhe akreditimin e këtyre programeve.

## 1.3 Tabela e Licensimit dhe Akreditimit



Fakulteti	Cikli i Studimit / Forma	Programi Studimor	Licensimi (VKM,Dt_)	Akreditimi (Urdh.Dt_)	Titulli i Diplomës
<b>Programe Studimi - BACHELOR</b>					
SHKENCA DENTARE	<i>Cikli i Parë /me kohë të plotë</i>	<b>Bachelor Teknika Laboratorike Dentare</b>	VKM Nr. 673, Dt. 27.09.2006	Urdhër, Nr.225 dt. 21.07.2009	<b>Laborant Dentar</b>
SHKENCA MJEKËSORE	<i>Cikli i Parë /me kohë të plotë</i>	<b>Bachelor në Infermieri të Përgjithshme</b>	VKM Nr. 794, Dt. 22.07.2009	Urdhër, Nr.240 dt. 26.05.2011	<b>Bachelor në Infermieri të Përgjithshme</b>
	<i>Cikli i Parë /me kohë të plotë</i>	<b>Bachelor në Fizioterapi</b>	Urdhër Nr. 370, Dt. 27.7.2011	Urdhër, Nr.326 dt. 07.08.2012	<b>Bachelor në Fizioterapi</b>
<b>Programe Studimi - MASTER SHKENCOR</b>					
SHKENCA DENTARE	<i>Cikli i Dytë i Integruar /me kohë të plotë</i>	<b>Master i Shkencave në Stomatolgji</b>	VKM Nr.257, Dt.27.02.2008	Urdhër, Nr.240 dt. 26.05.2011	<b>Master i Shkencave në Stomatologji</b>
SHKENCA MJEKËSORE	<i>Cikli i Dytë i Integruar /me kohë të plotë</i>	<b>Master i Shkencave në Farmaci</b>	Urdhër Nr.519, Dt. 19.11.2010	Urdhër, Nr.248 dt. 12.06.2013	<b>Master i Shkencave në Farmaci</b>
SHKENCA MJEKËSORE	<i>Cikel i Dytë /me kohë të plotë</i>	<b>Master Shkencor në Fizioterapi</b>	Urdhër Nr.195, Dt. 28.05.2013	/	<b>Master i Shkencave në Fizioterapi klinike</b>
<b>Programe Studimi - MASTER PROFESIONAL</b>					
SHKENCA MJEKËSORE	<i>Cikli i dytë /me kohë të plotë</i>	<b>Master Profesional në infermieri Klinike</b>	Urdhër Nr.527 Dt. 1/11/2012	-	<b>Master Profesional në infermieri Klinike</b>
<b>Programe Studimi - SPECIALIZIM AFATGJATË</b>					
SHKENCA DENTARE	<i>Cikli i tretë /me kohë të plotë</i>	<b>Specializim afatgjatë në Ortodonti</b>	Urdhër Nr.299 Dt. 22/7/2013	-	<b>Specialist në Ortodonci</b>
	<i>Cikli i Tretë /me kohë të plotë</i>	<b>Specializim Afatgjatë në Kirurgji Orale</b>	Urdhër Nr.299 Dt. 22/7/2013	-	<b>Specialist në Kirurgji Orale</b>



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

Rruga "Durrësit", Nr. 23, AL-1001, Tiranë – SHQIPËRI

[www.msh.gov.al](http://www.msh.gov.al)

Tel. 00 355 4 222 260

Nr. 4312 Prot.  
Tiranë, më 21.07.2009

**URDHËR**

Nr. 225, datë 21.07.2009


**PËR**

**AKREDITIMIN E FAKULTETIT TË TEKNIKAVE DENTARE DHE TË PROGRAMIT  
"LABORANT DENTAR" TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE  
"ALDENT"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 1, të nenit 62, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, mbështetur në rekomandimet e Këshillit të Akreditimit,

***URDHËROJ:***

1. Akreditimin e Fakultetit të Teknikave Dentare pranë shkollës së lartë universitare private "Aldent"
2. Akreditimin e programit të studimit "Teknika laboratorike dentare", me kohëzgjatje normale 3 vjet dhe me 180 kredite, në përfundim të të cilit lëshohet Diplomë e Nivelit të Parë (DNP), në "Teknika laboratorike dentare", e cila njihet zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë.
3. Shkolla e lartë universitare private "Aldent" do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të Fakultetit të Teknikave Dentare dhe programit të studimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij urdhri pas 6 vjetësh, sipas përcaktimit në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
4. Urdhri bëhet publik në faqen zyrtare të ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.



ministria e arsimit dhe shkencës

[www.msh.gov.al](http://www.msh.gov.al)

Urdhër për akreditim

Faqe 1 nga 2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
Ministri

Nr. 2758/1  
Prot.

Tiranë, më 12.6.2013

**URDHËR**

Nr. 248, datë 12.6.2013

**PËR**

**AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT "MASTER I SHKENCAVE" NË  
"FARMACI" NË SHKOLLËN E LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "ALDENT".**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin, në përputhje me vendimin nr. 468, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit, e programit të studimit "Master i shkencave" në "Farmaci".
2. Shkolla e lartë universitare private "Aldent" të plotësojë rekomandimet e përcaktuara në vendimin nr. 468, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Shkolla e lartë universitare private "Aldent" do t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programit të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, të nenit 62 të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
Ministri

Nr. 2386 /  
Prof. /

Tiranë, më 26.05.2011

**URDHËR**

Nr. 240, datë 26.05.2011

**PËR**

**AKREDITIMIN INSTITUCIONAL DHE TË DISA PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "ALDENT"**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:

**URDHËROJ:**

1. Akreditimin institucional të Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Shkollës së Lartë Universitare Jopublike, "Aldent", në përputhje me vendimin nr. 164, datë 15.04.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Bachelor" në: "Infermieri e Përgjithshme" dhe të programit të integruar të ciklit të dytë në përfundim të të cilit lëshohet diplomë "Master i Shkencave" në "Stomatologji", në përputhje me vendimin nr. 164, datë 15.04.2011 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Aldent", të plotësojë rekomandimet e parashikuara në vendimin e Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë nr. 164, datë 15.04.2011.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Ministri



100 Vjet Pavarësi

4259/  
Nr. Prot.  
1

Tiranë, më 07.08.2012

### URDHËR

Nr. 326, datë 07.08.2012

### PËR

**AKREDITIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “FIZIOTERAPI”, TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE “ALDENT”**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; dhe të nenit 62 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

### **URDHËROJ:**

1. Akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Fizioterapi” të shkollës së lartë universitare jopublike “Aldent” në përputhje me Vendimin nr. 353 datë 13.07.2012 të Këshillit të Akreditimit.
2. Shkolla e lartë universitare jopublike “Aldent”, bazuar në Vendimin nr. 353 datë 13.07.2012 të Këshillit të Akreditimit, bashkëlidhur këtij urdhri, të plotësojë rekomandimet e paraqitura në të përpëra fillimit të vitit të ri akademik 2012-2013.
3. Shkolla e lartë universitare jopublike “Aldent” do t’i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik të programeve të studimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri, çdo 6 vjet, sipas pikës 4, neni 62 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.